



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - РЕСПУБЛИКА КОСОВА QEVERIA E KOSOVËS - VLADA KOSOVA - GOVERNMENT OF KOSOVO MINISTRIA E BUJQËSISË, PYLLTARISË DHE ZHVILLIMIT RURAL МИНИСТАРСТВО ПОЛЈОПРИВРЕДЕ, ШУМАРСТВА И РУРАЛНОГ РАЗВОЈА MINISTRI DË AGRICULTURE, FORESTRY AND RURAL DEVELOPMENT Arhivi Qendror - Centralno Arhiva - Central Archive	
Nr./Br.No.	3325
i fq./Br. Str. No. pg.	3
10.08.2023 PRISHTINË PRISTINA PRISTINA	

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
Ministarstvo Poljoprivrede, Šumarstva i Ruralnog Razvoja
Ministry of Agriculture, Forestry and Rural Development

Kabineti i Ministrit / Kabinet Ministra / Cabinet of the Minister

Datë: 08.08.2023
Ref. KM-291/23

Në mbështetje të nenit 145 (paragrafi 2) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke marrë parasysh nenet 8, 9, 10 dhe 11 të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funkcionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura, (Gazeta Zyrtare, Nr. 7/ 01 mars 2019), duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 1.4) neni 15, Shtojca 11 të Rregullores (QRK)-Nr.02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive (30.03.2021), dhe Nenin 20 (paragrafët 1, 4 dhe 5) të Ligjit Nr. 03/L-042 i Produkteve për Mbrojtjen e Bimëve, (Gazeta Zyrtare Nr. 44, datë 22.12.2008) si dhe në bazë të rekomandimit të Komisionit për vlerësim dhe autorizim të Produkteve për Mbrojtjen e Bimëve, me Ref.04-382/23, të datës 31.07.2023, Ministri i Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, nxjerrë:

VENDIM

Për futjen në regjistër dhe lejimin e autorizimit të produktit për mbrojtjen e bimëve për përdorim

1. Lejohet importimi, vendosja në treg dhe përdorimi i autorizimit të produktit për mbrojtjen e bimëve – Switch 62.5 WG i prodhuesit “Syngenta Crop Protection AG”, Zvicër nga përfaqësuesi i saj “Fitofarma” SH.P.K, Ferizaj.

2. LLOJI I PRODUKTIT: Fungicid

3. PËRMBAJTJA E SUBSTANCËS AKTIVE: Fludioxonil.....25%
Cyprodinil.....37.5%

4. PËRDORIMI:

Ne **mollë, dardhë dhe ftua** kundër *Gloeosporium spp.*, *Botrytis cinerea*, *Penicillium spp.*, *Alternaria spp.*, *Monilia spp.*, *Colletotrichum spp.*, *Nectria spp.*, *Fusarium spp.*, *Venturia sp.*, me dozë 80-100 g/100 l uje, trajtimet parambrojtëse bëhen kur kushtet janë të favorshme për zhvillimin e sëmundjes nga fillimi i lulëzimit deri në pjekje.

Pjeshkë, nektarinë, kajsi, qershi, kumbull kundër *Monilia spp.* me dozë 60-100 g/100 l ujë, trajtimet parambrojtëse bëhen kur kushtet janë të favorshme për zhvillimin e sëmundjes nga fillimi i lulëzimit deri në pjekje.

Hardhi kundër kalbëzimit gri (*Botrytis cinerea*) me dozë 80 – 100 g/100 l ujë, trajtimet parambrojtëse bëhen kur kushtet janë të favorshme për zhvillimin e sëmundjes nga lulëzimi deri në pjekje.

Luleshtrydhe kundër kalbëzimit gri (*Botrytis cinerea*) (*Colletotrichum* spp.) me dozë 125 g/100 l ujë, Trajtimet parambrojtëse bëhen kur kushtet janë të favorshme për zhvillimin e sëmundjes nga fillimi i lulëzimit deri në pjekje.

Domate, patlixhan, spec kundër *Botrytis* spp., *Sclerotinia* spp. me dozë 80-100 g/100 l ujë, trajtimet parambrojtëse kur kushtet janë të favorshme për zhvillimin e sëmundjes nga lulëzimi deri në pjekje.

Kastravec, kungull kundër *Botrytis* spp., *Sclerotinia* spp., me dozë 80-100 g/100 l ujë, trajtimet parambrojtëse kur kushtet janë të favorshme për zhvillimin e sëmundjes nga frutifikimi deri në pjekje.

Karrotë kundër *Alternaria* spp., *Sclerotinia* spp., me dozë 100 g/100 l ujë, trajtimet parambrojtëse kur kushtet janë të favorshme për zhvillimin e sëmundjes nga faza e 4 gjetheve deri në zhvillimin e plotë.

Qepë, hudhër kundër *Botrytis squamosa* me dozë 120 g/100 l ujë, trajtimet parambrojtëse kur kushtet janë të favorshme për zhvillimin e sëmundjes nga faza e 5 gjetheve deri në zhvillimin e plotë.

Sallatë kundër *Botrytis cinerea*, *Sclerotinia* spp. me dozë 60 g/100 l ujë, trajtimet parambrojtëse kur kushtet janë të favorshme për zhvillimin e sëmundjes nga faza e gjethit të parë deri në zhvillimin e plotë.

Fasule kundër *Botrytis cinerea*, *Sclerotinia* spp., *Colletotrichum* spp., me dozë 100 g/100 l ujë, trajtimet parambrojtëse kur kushtet janë të favorshme për zhvillimin e sëmundjes nga lulëzimi deri në shfaqjen e bishtajve

Duhan kundër *Alternaria* spp., *Sclerotinia* spp., me dozë 80 g/100 l ujë, trajtimet parambrojtëse kur kushtet janë të favorshme për zhvillimin e sëmundjes nga fillimi i lulëzimit deri në përfundimin e tij.

Bimë zbukuruese kundër *Botrytis cinerea*, *Aspergillus* spp., me dozë 100g/100 l ujë, trajtimet parambrojtëse kur kushtet janë të favorshme për zhvillimin e sëmundjes.

PËRZIHET me sukses me insekticidet dhe fungicidet e zakonshme. Në rast përzierje hidhni në fillim Switch veç rasteve kur preparati tjetër është formulim WSB (qese e tretshme në ujë).

FITOTOKSICITETI: Nuk është fitotoksik kur përdoret në kulturat dhe dozat e rekomanduara.

5. SASIA E AMBALAZHIMIT PËR IMPORTIM:

100g, 1kg, 5kg

6. VËREJTJE:

Numri maksimal i trajtimeve për çdo sezon, vresht 2, domate, patlixhan, trangull dhe luleshtrydhe 2-3. Përdorni dozat e ultë në fillimin e infeksionit. Dozat e larta përdoren në infeksione të rënda, duke bërë lagje të mire të masës vegjetative dhe veçanërisht të frutave, por duke patur parasysh që doza të mos kalojë 120 gr/dylym.

Në vresht zgjidhni me kujdes fazën fenologjike kur do trajtoni në vartësi të rrëzikut të infeksionit dhe të programeve të trajtimeve të çdo zonë. Për të evituar shfaqjen e rezistencës rekomandojmë alternimin e SWITCH-it me fungicide të tjera që kanë mënyrë tjetër veprimi.

7. KARENCA:

Hardhi: 21 ditë.

Domate, Patlixhan dhe Trangull: 7 ditë.

Luleshtrydhe: 14 ditë.



8. PROPOZIMI I KLASIFIKIMIT: GHS07- ngacmues, irritues (cat 2 ose 3)



GHS09-paralajmerim (cat 1)-i rrezikshëm për ambient.

9. VENDI I SHITJËS: Në tërë territorin e Republikës së Kosovës.

10. Produkti për mbrojtjen e bimëve i autorizuar nga pika 1 e këtij vendimi lejohet të importohet në Republikën e Kosovës, deri në afatin siç është përcaktuar në certifikatën e regjistrimit, duke u bazuar në Databazën e Pesticideve të BE-se/Substancave aktive, ndërsa qarkullimi dhe përdorimi i tij lejohet sipas nenit 26 paragrafi 3 i Ligjit Nr.03/L-042 i Produkteve për Mbrojtjen e Bimëve.

11. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Vendimi i dërgohet:

- Komisioni për vlerësimin dhe autorizimin e produkteve për mbrojtjen e bimëve;
- Departamenti i Politikave Bujqësore dhe Tregjeve;
- Shërbimi kufitar fitosanitar;
- Inspektorët fitosanitar AUV;
- Importuesit të produkteve për mbrojtjen e bimëve;
- Arkivit.



Faton Peci,

Ministër